



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Lidhur me kërkësën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korruptionit (DPK-03-3162/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korruptionit lidhur me çështjen e konfliktit e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korruptionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkësën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	18.09.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	znj. Suzan Dërvari, Drejtor, Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
CC:	z. Bedri Hamza , Guvernator i Bankës Qendrore te Republikës se Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



E nderuar znj. Dervari

Lidhur me kërkësën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korruptionit (DPK-03-3162/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korruptionit lidhur me çështjen e konfliktit e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korruptionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkësën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, duke ju përgjigjur kërkësës tuaj dhe pas takimit qe kemi pasur me ju në zyrat e BQK-së, dhe pas ofrimit te fakteve lidhur me kërkësën tuaj drejtuar AKK-së, për sqarimin e situatës qe ndërlidhet me pronësinë e zyrtarit te lart z. Akan Ismaili (Ambasador i Kosovës ne SHBA), ne një kompani e cila është aksionare ne një kompani tjetër e cila ka aplikuar ne BQK-ë, për tu

licencuar si kompani e sigurimeve, dhe a përben konflikt te interesit sipas dispozitave ligjore ne fuqi ky fakt.

Agjencia kundër Korruptionit si institucion kompetent lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit ne ushtrim te funksionit publik, nxjerr këtë:

OPINION

Aplikimi i kompanisë nga personi i autorizuar për licencë në Bankën Qendrore te Republikës se Kosovës, për tu licencuar si kompani e sigurimeve, ku zyrtari i lartë z. Akan Ismaili, ka pjesë te aksioneve nuk paraqet konflikt te interesit në ushtrim te funksionit publik dhe nuk është e ndaluar.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (në tekstin e mëtejmë L.P.K.I.) pozita e Ambasadorit hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, andaj në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Prandaj, aplikimi i kompanisë nga personi i autorizuar për licencë ne BQK, për tu licencuar si kompani e sigurimeve, ku zyrtari i larte z. Akan Ismaili, ka pjesë të aksioneve nuk paraqet konflikt të interesit në ushtrim te funksionit publik, për faktin se zyrtari i lartë z. Akan Ismaili, ka autorizuar një person si person të autorizuar në biznesin ku z. Ismaili është bashkëpronar, e ter kjo lidhet me Nenin 14.1 dhe 2 te ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përshkruhet transferimi i te drejtave në drejtim te ndërmarrjes.

Në bazë të kësaj dispozite, të jesh bashkëpronar i biznesit nuk është e ndaluar, mirëpo zyrtari i lartë në bazë te nenit 16.1 të ligjit të lart përmendor nuk mund te jetë menaxher, apo anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues në ndërmarrje private.

Po ashtu duhet theksuar se çështja e transferimit te drejtave në drejtim te ndërmarrjes tek personi e autorizuar është rregulluar me nenin 14.4,5,6 te Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

4. Nëse personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet e qeverisjes qendrore, lokale, ndërmarrjet publike apo me ndërmarrjet private ku kapitali i pronës publike ka më shumë se pesë (5)% të kapitalit apo aksioneve, është i detyruar që të njoftoj zyrtarin e lartë lidhur me marrëdhëni e tillë afariste.

5. Gjatë kohës derisa të drejtat për administrim me ndërmarrjen i janë transferuar personit tjeter, zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të jap informata, udhëzime, urdhëresa apo në ndonjë mënyrë tjeter të qëndroj në lidhje me personin e besuar ashtu që të ketë ndikim në realizimin e të drejtave dhe përbushjen e detyrave që dalin nga të drejtat e anëtarëve të ndërmarrjeve të tillë.



6. Zyrtari i lartë ka të drejtë të informohet për ecuritë dhe gjendjen në ndërmarrjen ku ka pronësi, ose pjesë të pronësisë.

Andaj, bazuar në faktet dhe gjendjen e tanishme lidhur me çështjen e ngritur nga ana e juaj si dhe në bazë asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, ndërsa në rast se paraqiten fakte dhe rrëthana tjera kërkojmë që të parandaloni çdo situatë qe mund te shkaktoj konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!

